



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 16.2.2024

- Lënda:** Bisedime përfundimtare të Komisionerit Publik, në seancën gjyqësore të datës 16.2.2024, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 651, datë 27.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Urim Buci
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303, të Kodit të Procedurës Civile, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 13.6.2023 dhe parashtrimeve të paraqitura në seancën e datës 8.2.2024, bazuar dhe në Rekomandimin e vëzhguesve ndërkombëtarë të datës 30.5.2023, në mënyrë të përmbledhur, vlerëson se:

1.1 ***Për shkakun ankimor lidhur me pasurinë tokë arë (dy parcela) dhe godinë e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo***, Komisioneri Publik vlerëson se, edhe pas shqyrtimit të çështjes në Kolegj, nuk u provuan pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi deklaratimet kontradiktore lidhur me pjesët takuese, kohën, vlerën, kontributet reale dhe burimet e ligjshme të përdorura për krijimin e kësaj pasurie, të detajuara në vijim:

1.1.1 Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë pretendimet lidhur me masën e kontributit të tij, të vëllait z. ***, ***, si dhe kunatit z. ***, ***,

1.1.2 Nuk u provuan pretendimet e subjektit lidhur me koston totale të investimit për ndërtimin e kësaj pasurie.

1.2 Në analizë të akteve të administruara, bazuar edhe në Rekomandimin e ONM-së të datës 30.5.2023, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në Kolegj, Komisioneri Publik, për sa

trajtuar gjerësisht në ankim dhe në parashtrimet e seancës gjyqësore të datës 8.2.2024, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, përveç sa më sipër, nuk provoi as burimet e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë *godinë e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo*¹, duke analizuar si më poshtë:

1.2.1 Subjekti i rivlerësimit ka qenë kontradiktor në deklaratime, duke referuar vlera të ndryshme të investimit në D-Vett., në deklaratën e pasurisë së vitit 2004, në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2015 dhe në përgjigjet e dhëna gjatë procesit të hetimit administrativ, lidhur me vlerën/kostot e ndërtimit të pasurisë *godinë banimi 3 kate + 1 kat papafingo*, si edhe deklaratimet mbi ndërtimin e një pjesë të pasurisë nga shtetasi ***. ***, dhe pretendimet mbi mbulimin e kostove të investimit nga ky i fundit.

1.2.2 Kontradiktore dhe të paprovuara mbetën deklaratimet e subjektit lidhur me vlerën e ndërtimit dhe burimet e përdorura, referuar akteve: (i) DV-2004, ku deklarohet vlerë ndërtimi prej 10.000.000 lekë², pjesë takuese 50%, vit krijimi 1995, dhe burim: të ardhura të vëllait nga emigracioni; (ii) DV-2015 (para fillimit të detyrës), ku subjekti nuk deklaroi vlerë (kosto) të pasurisë, deklaroi pjesë takuese 100% dhe burim krijimi: të ardhurat e tij nga emigracioni gjatë viteve 2000-2004, pa përcaktuar shumën e këtyre të ardhurave; (iii) D-Vett., ku subjekti deklaroi vlerë ndërtimi 6.918.2015 lekë, pjesë takuese 100%, me burim të ardhura nga emigracioni gjatë viteve 2000-2004 dhe (iv) në prapësimet e tij, gjatë hetimit administrativ, subjekti pretendon se është investuar prej tij vetëm vlera prej 3.576.580 lekë³. Edhe gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, nuk rezultoi që subjekti të ketë provuar me akte, pretendimet e mësipërme.

1.2.3 Në këto kushte, deklaratimet kontradiktore lidhur me vlerën e investuar në këtë pasuri dhe burimet e përdorura për krijimin e saj, çojnë në pamundësi të kontrollit dhe verifikimit të saktë të burimeve, kohës dhe vlerës së krijimit të kësaj pasurie.

1.2.4 Në përfundim të shqyrtimit të çështjes në Kolegj, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit, edhe për sa i përket burimeve të ligjshme të përdorura për investimin në *godinën e banimit 3 kate + 1 kat papafingo*, të analizuar në të gjitha variantet e deklaruara nga ana e subjektit, nuk arriti të provojë burimet e pretenduara si të ardhura nga emigracioni në Mbretërinë e Bashkuar dhe ligjshmërinë e tyre sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës dhe jurisprudencës së Kolegjit.

¹ Nga aktet e administruara në dosje, si nga korrespondenca e Komisionit dhe ato të paraqitura nga subjekti, z. Buci, në konsideratë të konstatimit se pasuria *godinë e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo*, nuk ka pësuar ndryshime pas vitit 2015, rezultojnë këto të dhëna: (1) pasuria me numër ***/***/***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 180m², pronari, subjekti i rivlerësimit, z. Buci, pjesa takuese 1/1; (2) pasuria me numër ***/***/***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 132m², pronari, subjekti i rivlerësimit, z. Buci, pjesa takuese 1/1; (3) pasuria me numër ***/***/***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 170m², pronari, subjekti i rivlerësimit, z. Buci, pjesa takuese 1/2; (4) pasuria me numër ***/***/***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 111m², pronari, subjekti i rivlerësimit, z. Buci, pjesa takuese 1/2.

² Për këtë vlerë të deklaruar, subjekti pretendon se janë deklaruar në “lekë të vjetra”. Sikundër konstatohet edhe në Rekomandimin e ONM-së, duket se ky pretendim i subjektit nuk qëndron, pasi, në të njëjtën deklaratë, subjekti ka deklaruar “në lekë të reja” blerjen e automjetit në shumën 600.000 lekë dhe të ardhurat nga paga 46.000 lekë.

³ Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në parashtrime se pjesa tjetër e investimit është kryer nga shtetasi ***. ***, për katin II, në vlerën 2.191.960 lekë, pa TVSH. Duket se ky pretendim bie ndesh me deklarimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit në procesverbalin e ILDKPKI-së, ku ka deklaruar se: “... në katin e dytë banon dhëndri im, pa detyrim për momentin...”.

1.2.5 *Komisioneri Publik* sjell në vëmendje edhe mosdeklarimin nga ana e subjektit të posedimit të kursimeve në “likuiditete *cash*”, në deklarimin e parë pranë ILDKPKI-së, në vitin 2005, në pozicionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore.

1.2.6 Pamjaftueshmëria financiare e konstatuar nga mungesa e akteve mbi burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë *godinë e kombinuar banimi 3 kate + 1 kat papafingo*⁴, pasaktësitë dhe deklarimet kontradiktore të subjektit të rivlerësimit mbi kontributin dhe pjesën takuese në këtë pasuri, së bashku me pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar nga Komisioni për mbulimin e shpenzimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të për vitin 2016⁵, çojnë në situatën ligjore që subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016⁶.

2. Lidhur me denoncimet e paraqitura në Kolegjin e Posaçëm të Apelit përçjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë,⁷ për të cilat, me vendimin e ndërmjetëm të shpallur në seancën gjyqësore publike të datës 8.2.2024, u çel hetimi gjyqësor dhe u administruan aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, z. Urim Buci, Komisioneri Publik vlerëson për secilin prej tyre sa vijon:

2.1 ***Denoncimi i shtetasit*** ***, ***, referuar përmbajtjes së dokumentacionit në raport me parashikimet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, identifikohet praktika, e cila lidhet me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, konkretisht vendimi i pushimit të procedimit penal nr. ***, datë **.10.2017, akti më i fundit procedural i gjendur në këtë dokumentacion është urdhri “*Për delegim dhe kryerjen e veprimeve hetimore*”, i datës **.6.2023, nga i cili rezultojnë këto të dhëna:

2.1.1 Ky procedim penal është regjistruar më datë **.10.2017, për kundërvajtjen penale të “Vetëgjyqësisë”, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, dhe gjendja e këtij procedimi penal ka qenë në hetim në datën **.6.2023. Vendimi i pushimit të procedimit penal nr. ***, datë **.10.2017 është rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Dibër, me vendimin e datës **.2.2019, i lënë në fuqi me vendimin e Gjykatës së Apelit Tiranë me vendimin e datës **.5.2019. Në vazhdim, vendimi i dyti në radhë për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë **.10.2017, për kundërvajtjen penale të “Vetëgjyqësisë” është ankimuar në Gjykatë, e cila, me vendimin e datës **.4.2021, ka vendosur pranimin e ankimit, i ankimuar ky vendim nga Prokuroria Dibër, dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin e datës **.12.2022, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër.

2.1.2 Nga sa më lart, në gjendjen që janë aktet, rezulton se për kundërvajtjen penale të “Vetëgjyqësisë” me marzh dënimi: *me gjobë deri në tre muaj*, procedura hetimore dhe ajo e gjykimit ka zgjatur për një periudhë 6 vjet dhe duket se veprimet hetimore të subjektit të rivlerësimit janë gjetur të paplota nga vendimet e gjykatave dhe vetë procedimi penal ka qenë

⁴ Referohuni vendimit të Komisionit në f. 22, prg. 2.20.7.

⁵ Referohuni arsyetimit të Komisionit në f. 33-34, të vendimit.

⁶ Komisioneri Publik konstaton, gjithashtu, se përfundimi tjetër i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit e ka krijuar pasurinë përpara marrjes së detyrës, bie në kundërshtim me jurisprudencën e qëndrueshme të Kolegjit, referuar vendimeve (JR) nr. 2/2019, nr. 31/2019, nr. 12/2020, nr. 13/2020 dhe nr. 3/2021. Për rrjedhojë, vlerësimi i Komisionit në këtë rast, duke referuar vendimin e Kolegjit (JR) nr. 6/2022, është jorelevant me situatën faktike dhe rrethanat objektive të rastit objekt ankimi, e për këtë arsye, ky vendim nuk mund të merret në konsideratë për subjektin e rivlerësimit, z. Buci.

⁷ Shkresa me nr. **/** prot., datë **.2.2024.

në fushën e veprimit të nenit 66, “Parashkrimi i ndjekjes penale”, germa “d”, të Kodit penal, duke treguar se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe aftësisë organizative, sipas parashikimeve të nenit 73 dhe 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e magjistratëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2.2 Denoncim i shtetasit **. **, referuar përmbajtjes së dokumentacionit në raport me parashikimet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, identifikohet praktika, e cila lidhet me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, konkretisht, kërkesa për gjykim i procedimit penal nr. ***, datë **.11.2020, të regjistruar për veprën penale të “Dhunës në familje”, parashikuar nga neni 130/a/4 i Kodit Penal. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Dibër, me vendimin nr. ***, datë **.12.2022, ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit *** *** dhe, në aplikim të nenit 59, ka disponuar me pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë për një periudhë kohe prej 2 vite e 8 muaj. Subjekti i rivlerësimit, z. Buci, ka nxjerrë urdhrin për ekzekutimin e vendimit penal nr. ***, datë **.12.2022, ku si bazë ligjore ka vendosur edhe ndryshimet e nenit 59 të Kodit Penal me ligjin nr. 36/2017, të lidhura këto me afatin e provës dhe fillimin e ekzekutimit të tij.

2.2.1 Sa më sipër përshkruar nuk vërehen mangësi apo të meta nga veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, z. Buci.

2.3 Denoncim/Kërkesë e shtetasit *.** ***, referuar përmbajtjes së dokumentacionit në raport me parashikimet e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, identifikohet praktika, e cila lidhet me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, konkretisht praktika e vënies në ekzekutim të vendimit penal nr.***, datë **.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër.

2.3.1 Pas shqyrtimit të dokumentacionit lidhur me këtë çështje rezulton se, për vendimin penal me nr.***, datë **.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër, fillimisht ka dalë urdhri i ekzekutimit nga një tjetër subjekt rivlerësimi me urdhrin e datës **.9.2016, i cili rezulton se nuk është ekzekutuar. Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Dibër, me shkresën nr.***, datë **.9.2023, i drejtohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Dibër me lëndë: dërgohet vendim penal i formës së prerë, ku përcillen vendimi nr. ***, datë **.5.2015, që i përket të pandehurit/kërkuesit *** *** dhe një kopje të vendimit nr. ***, datë **.7.2022, të Gjykatës së Lartë. Subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë urdhrin nr.***, datë **.9.2023, “Për ekzekutimin e vendimit penal të formës së prerë...”, sipas të cilit urdhërohet arrestimi dhe transferimi i të dënuarit ***. ***, ku të mbahet për një periudhë 2 muaj burgim, duke filluar llogaritja e afateve nga dita e ekzekutimit të këtij urdhri. Veprime të mëtejshme të subjektit, z. Buci, në funksionin e prokurorit, rezultojnë këto në vijim, vendimi i datës **.11.2023,⁸ “Për revokimin e urdhrin të ekzekutimit...”, sipas të cilit citojmë: “[...] ekzekutimi i dënimit të caktuar me vendimin nr.***, datë **.5.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër, i cili ka marrë formë të prerë më datë **.06.2016, në bazë të nenit 68, germës “c”, të Kodit Penal, është parashkruar, për pasojë dënimi i dhënë me këtë vendim duhet të deklarohet i shuar, prandaj duhet të revokohet urdhri i ekzekutimit [...]”, dhe kërkesën e datës **.11.2023, drejtuar Gjykatës, me objekt: shuarjen e dënimit të dhënë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Dibër me nr.***, datë **.5.2015, ku si bazë ligjore vendos edhe vendimin penal unifikues me

⁸ Vërejmë se data e urdhrin është **.3.2023, ndërkohë që në përmbajtje të këtij vendimi rezulton referimi për ndalimin e shtetasit ***. ***, nga Komisariati i Policisë nr. 5, Kamëz, më datë **.11.2023, dhe urdhri i ekzekutimit i datës **.10.2023, të dyja rrethanat citojnë muajt nëntor dhe tetor të vitit 2023, ndaj referimi në muajin mars duket që është *lapsus*.

nr.**, datë **.10.2002, të Gjykatës së Lartë. Gjykata, me vendimin e datës **.11.2023, ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova, ku në arsyetimin e vendimit, Gjykata ka përdorur edhe referenca të jurisprudencës së aplikueshme për çështjen në gjykim, konkretisht, vendimin penal unifikues nr. 2, datë 3.11.2014.

2.3.2 Nga sa më lart, në gjendjen që janë aktet, rezulton se vendimi i datës **.11.2023, për revokimin e urdhrit të ekzekutimit të datës **.9.2023, është i pambështetur në dispozitat ligjore procedurale penale dhe jurisprudencës në fuqi, lidhur me ekzekutimin e vendimit penal, konkretisht vendimi unifikues penal me nr. 2, datë 3.11.2014, duke treguar se subjekti ka shfaqur mangësi në aspektin e njohurive ligjore, sipas parashikimit të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e magistratëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2.4 Në përfundim, duke pasur parasysh se **shkaku ankimor lidhur me marrëdhënien kontraktuale të qirasë të subjektit me Bashkinë Kamëz** qëndron i njëjtë, sikurse parashtruar në ankimin e datës 13.6.2023 dhe parashtrimeve në seancën gjyqësore publike të datës 8.2.2024, edhe pas prapësimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, z. Buci, dhe se nga vlerësimi i denoncimeve të publikut, janë vërejtur të meta e mangësi të subjektit të rivlerësimit, z. Buci, në aftësinë për të ndërmarrë hetimin apo kryer ekzekutimin e vendimit penal, të cilat, edhe pse të vetme, nuk mund të shërbejnë si bazë për aplikimin e masës së parashikuar në nenin 61, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, ato së bashku të mbahen në konsideratë nga Kolegji në eventualitetin e vlerësimit tërësor të procedurës së rivlerësimit sipas kërkesave të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

I. Kërkimi përfundimtar i ankimit

3. Komisioneri Publik, mbështetur në sa më sipër trajtuar, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkon nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 651, datë 27.4.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra e subjektit të rivlerësimit, z. Urim Buci.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO